

Ky material është tërësisht ose pjesërisht i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim (SIDA) dhe We Effect. SIDA dhe We Effect nuk nënkupton që pajtohen me mendimet e shprehura.



Gra aktive në mjediset rurale - në mënyrë kontribuojnë për zhvillimin e komunitetit lokal



Në periudhën prej qershor deri dhjetor 2019, organizata «Koalicioni Rural» në bashkëpunim me organizatën partnere të grave fermerë Moja Farma ka realizuar projektin: «**Gra aktive në mjediset rurale - në mënyrë kontribuojnë për zhvillimin e komunitetit lokal**» si pjesë e projektit për përforcim të kapaciteteve të RZR dhe anëtarëve, të financuar nga Organizata Suedeze Zhvillimore We Effect. Projekti trajton temën e barazisë gjinore për barazi në mjediset rurale, por është drejtuar për aktivitete ekonomik të grave si dhe të nxiten ato që më tepër të aktivizohen në nivelin lokal, si në proceset e miratimit të vendimeve, ashtu edhe në pjesën e nisjes ose zhvillimit të biznesit bujqësor në ekonominë familjare bujqësore. Aktivitetet ishin fokusuar në dy rajone të planifikimit në nivelin lokal që ve-

projnë organizatat partnere që kanë zbatuar projektin: Rajonin e planifikimit të Pollogut dhe Verilindor. Me anë të aktiviteteve të parashikuara në fillim ishte vendosur gjendja e vërtetë në teren kur bëhet fjalë për përfshirjen e grave në mjediset rurale në politikat lokale, informimin mbi proceset e buxhetimit të ndjeshëm gjinor, si dhe për mundësitë e aktivitetit ekonomik dhe përforcim të mjedisve rurale, që më vonë me anë të konferenca lokale të shtypit përforcohet komunikimi me mediat lokale dhe transmetimit të rezultateve tek opinioni më i gjerë. Ishin përfshirë 100 të anketuar/gra të mjedisve rurale nga dy rajonet e planifikimit.

Pas segmentit të hulumtimit, vijon pjesa e rritjes së arsimit joformal për gratë rurale, emancipimi i tyre, si dhe vendosja e veglave



praktike në dispozicion për ndikim në komunitetin lokal, gjegjësit ka vijuar ligjëratë edukative në të cilat 25 gra dhe burra kanë pasur mundësi për të fituar njohuri praktike mbi temën: Krijimi i politikave të ndjeshme gjinore, mekanizma për pjesëmarrjen e miratimit të vendimeve në komunitetin lokal, si dhe zhvillimin e shkathtësive sipërmarrëse në biznesin bujqësor. Në fazën e dytë, projekti ishte fokusuar në aktivitete më konkrete dhe rrjetëzim të grave nga dy pilot rajonet (Verilindore dhe Pollogut) me themelimin e grupit joformal të grave nga mjediset rurale të quajtur lobi rural i grave, dhe me qëllim të mund në mënyrë të drejtpërdrejtë të prezantojë dhe të afrojë praktikën pozitive të veprimit dhe përvojave të grave që kanë kaluar rrugën e përfshirjes ekonomike dhe sociale në shoqëri dhe që vetëm më kanë praktikë të veprimit aktiv në komunitet dhe janë të njohur në këtë formë.

Qëllimi i shkëmbimit të përvojave pozitive dhe praktikave është të motivohen sa më shumë gra të praktikojnë barazinë gjinore dhe ekonomike të aktivizohen si në ekonominë familjare bujqësore, ashtu edhe në komunitetin lokal.

Tryezë kombëtare e rrumbullakët në temën: *Mundësitë ekonomike dhe sfidat e grave të mjediseve rurale ka pasur për qëllim të diskutohen jo vetëm rezultatet e projektit por edhe të përcaktohen drejtimit e ardhshme në të cilat do të duhet të punohet dhe edhe pas përfundimit të projektit, dhe me qëllim të mundësohet vazhdimi dhe qëndrueshmëria.*



Toka shtetërore bujqësore në duart e oligarkëve më të fuqishëm ose tek fermerët e vërtetë



Toka shtetërore bujqësore në duart e oligarkëve më të fuqishëm ose tek fermerët e vërtetë është një temë tjetër që është fokusuar organizata "Koalicioni Rural" në periudhën qershor-dhjetor 2019. Qëllimi i këtij projekti ishte që me anë të informimit me kohë dhe alarmimit të fermerëve në bashkëpunim me mediat që të arrihet në procedurë transparente, publike dhe të pa korruptuar të dhënies së tokës bujqësore shtetërore. Aktivitetet e projektit ishin fokusuar në 2 rajone të planit ▢ Verilindor dhe Pellagonisë, ndërsa rezultatet kryesore që ishin arritur ishin: Sigurimi i informacioneve themelore, të sakta dhe objektive për procedurën e dhënies së tokës bujqësore shtetërore dhe kapac-

itete të përforcuar të shoqatave-anëtare të Koalicionit Rural në bashkëpunim me mediat lokale për ndjekje të papenguar dhe informuar dhe alarmim për procedurat për dhënien e tokës bujqësore shtetërore. Rezultatet ishin arritur me anë të realizimit të aktiviteteve të shumta përfshirë edhe gjitha palët e përfshirë në procesin - institucione lokale, komuna, njësi rajonale të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, Inspektorati Shtetëror Bujqësor, shoqata dhe fermerë individual, etj. Me anë të hulumtimit, organizim të dy ligjëratave edukative, përpilimit të video lajmit dhe videos edukative në bashkëpunim me partner lokal mediatik, konferenca lokale të shtypit, si dhe



tryezë kombëtare të rumbullakët prej të cilës edhe doli dokumenti për politika publike që ka për qëllim për të avancuar transparencën e thirrjeve publike dhe shpalljeve për dhënien e tokës shtetërore bujqësore, të kontribuojë për të hapur procesin dhe procedurën për dhënien e tokës shtetërore bujqësore, por edhe vetë fermerët me anë të foljes së hapur për procesin për të ndikuar jo vetëm mbi transparencës por edhe mbi uljen e korrupsionit, shpërndarjes së padrejtë të tokës, si dhe të përshpejtojnë procesin e revizionit të tokës së vetëm të dhënë. Koalicioni Rural ka realizuar projektin si nëngrant në kuadër të projektit **“OJQ dhe medie kundër korrupsionit - koalicioni për zero tolerancë”** të mbështetur nga BE-ja, që zbatojnë Transparencë Maqedoni dhe OJQ Inforcentar Video materialet mund të gjenden edhe në ueb faqen e organizatës – www.rural.mk si dhe të partnerit lokal mediatik Infokompas - <https://infokompas.com.mk/>. (fotografitë në vazhdim)

Zbutja e efektit të ndryshimeve klimatike me anë të zbatimit të praktikës së mirë bujqësore

Koalicioni Rural gjatë periudhës së fundit ka punuar dhe në zbutjen e efektit nga ndryshimet klimatike me anë të zbatimit të praktikës së mirë bujqësore, duke u fokusuar edhe në edukimin dhe zbatimin praktik të praktikës së mirë bujqësore për të cilën ishte dëshmuar që mbi 88% të fermerëve nuk zbatojnë, dhe me atë drejtë ndotin mjedisin jetësor dhe në mënyrë të pavetëdijshme shkaktojnë efekte negative të cilat ndotja dhe

ndryshimet klimatike i kanë mbi prodhimtarinë bujqësore. Ishin realizuar 5 punëtori edukative në 5 rajone të planifikimit, ishte hartuar manual për zbatimin e praktikës së mirë bujqësore që ishte promovuar dhe shpërndarë drejtë në teren para fermerëve në 10 rajoneve të ndryshme bujqësore n. shtetin. Projekti ishte mbështetur financiarisht nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.



Java e gruas rurale

Koalicioni Rural ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas Rurale, me anë të organizimit të aktiviteteve të ndryshme me moton «Java e gruas rurale, në periudhën prej 14-18 tetor 2019. Në kuadër të javës së gruas rurale ishte organizuar konferencë lokale për shtyp për prezantim të rezultateve të fituar në hulumtimin lokal të ndjeshmërisë gjinore dhe njohjes së të drejtave të grave në komunitetin lokal, ishte promovuar raporti i hartuar në kuadër të projektit «Gra aktive në mjediset rurale» në mënyrë kontributive për zhvillimin e komunitetit lokal» dhe ishte organizuar ligjërata në temën: «Përse në veçanti flitet për të drejtat e njeriut për

gratë në mjediset rurale?», në të cilën gratë janë njoftuar më mirë me temat si: Indeksi gjinor, dhuna e bazuar në gjini, buxhetimi me përgjegjësi gjinore, dhuna e bazuar në gjini si dhe përfshirja e perspektivës gjinore në politikat për bujqësi dhe zhvillim rural në nivelin kombëtar dhe lokal. Në mesin e ngjarjeve ishte promovuar edhe mesazhi i UN Women për këtë vit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale, me të cilën theksohej edhe rëndësia dhe mbështetja e gruas për prodhimtarinë e ushqimit, por edhe për përballimin e ndryshimeve klimatike që kanë ndikim të madh mbi prodhimtarinë bujqësore.



Gratë rurale për zhvillim rural

Për të ngritur vetëdijen e komunitetit lokal për rëndësinë e barazisë gjinore, si dhe të sigurojë mbështetje të grave rurale në pjesën e prodhimtarisë dhe përfshirjes së tregut të punës, "Preda Plus" dhe "Vizioni" në kuadër të projektit GRATË RURALE PËR ZHVILLIM RURAL, kanë realizuar aktivitete për promovim të barazisë gjinore, përmirësimit të statusit të grave dhe kapaciteti i tyre për miratimin e vendimeve në gjitha nivelet dhe në gjitha sferat e jetës si faktor për ngritjen e zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit, gratë nga Rosoman gjatë muajve vijues në mënyrë aktive ishin të përfshirë në trajnime për përforsim ekonomik të përmirësimit të statusit të tyre shoqëror. Nga trajnimet e ndryshme ndahen ata për shortimin e fidanëve me pjeshkë dhe trajnimi për marketing (paketimin dhe etiketimi i produkteve) si hap për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësim të statusit të grave.

Gjithashtu, me qytetarët e komunës Rosoman ishin realizuar punëtori për ndjeshmërinë gjinore, në të cilën ishte diskutuar për rëndësinë e barazisë gjinore si bazë për pavarësinë ekonomike dhe përmirësimin e statusit të grave në komunën Rosoman.

Të dhënat për paraqitjen e nyjës gjinore në aktivitetin e tregut të punës dhe në rrogat do të thotë që gratë kanë standard më të dobët të jetës dhe janë më të ekspozuar në varfëri, por gjithashtu kjo i bënë edhe të pa-



varur nga burrat dhe familjet e tyre. Më të ekspozuar në këto rreziqe janë gratë e rajoneve rurale ku papunësia dhe mungesa e aktiviteteve të grave në tregun e punës janë më të shprehura. Mungesa e ndjeshmërisë gjinore gjatë zbatimit të politikave mbetet rrezik-faktor që pasqyrohet në zbatimin operativ të politikave dhe efekteve të tyre mbi uljen e nyjës gjinore. Të dhënat tregojnë që gratë në mjediset rurale pjesën më të madhe të kohës së tyre, 4 orë dhe 22 minuta, dedikojnë në aktivitete shtëpiake, të paguar, ndërsa vetëm 1 orë e 18 minuta në ditë në aktivitete që ju mundëson realizimin e kompensimit financiar. Një prej arsyeve kryesore për varësinë ekonomike të grave është fakti që ata ndërmarrin përgjegjësinë themelore për punën e paguar në shtëpi.

Për të kontribuar drejt promovimit të grave rurale, PREDA Plus në mënyrë intensive ka punuar në fushatën për rritjen e dukshmërisë së grave në mjediset rurale edhe atë me anë të mediave sociale, portaleve relevante dhe medie të shtypura. Për këtë qëllim, PREDA Plus krijon një faqe për adhuruesit të shoqatës "RAJ" nga Rosomani që ishte themeluar në vitin 1994, një prej shoqatave të para të formuar në vend, dhe me siguri një prej të parave në rajon rural, për të ngritur vetëdijen tek gratë dhe realizimin e interesave personale dhe ato të përbashkëta.

Ka një numër i lartë i historive inspiruese për gratë e suksesshme dhe inspiruese nga Rosomani që mund të transformohen në histori mediatike me të cilat do të promovohen gratë rurale nga Rosomani gjithashtu edhe puna e tyre dhe prodhimtaria me të cilën do të merren, dhe me atë edhe potencialin dhe vlerën e vetë komunës.

Para anëtarëve të "RAJ" nga Rosomani ishin prezantuar teknika që mund të përdoren për disa prej temave të tyre interesante dhe

historitë të gjejnë vendin në mediat elektronike dhe të shtypura. Në bisedë me ata ishte vendosur që të përpilohen intervista me anëtarë të caktuar që kanë histori interesante. Historitë do të përdoren për lajme që mund të publikohen në portale, media të shtypur si dhe në faqen e adhuruesve të "RAJ" Rosomani. Historitë ishin publikuar në tre portale të ndryshme: Zelena Berza, Zenski Magazin dhe MM Magazin si dhe dy intervista në revistën e shtypur të Zele-na Berza. Historitë janë të ndarë në faqen e adhuruesve të portaleve si dhe në faqen e adhuruesve të "RAJ" nga Rosomani.

Në kuadër të projektit, Vizioni nga Kavadari, në periudhë prej 3 muajve ishte realizuar një program mentorimi dhe punëtori me përfaqësues të shoqatës "RAJ" nga Rosomani, me qëllim të përfortimit të kapaciteteve të organizatës së vetme të grave në komunën Rosoman për efikasitet dhe efektivitet të rritur në punën. Me këtë aktivitet ju sigurohet gjithë grave të komunës Rosoman një aktor relevant që do të ndihmojë në promovimin e barazisë gjinore në komunën si faktor të rëndësishëm për zhvillim rural.

Aktivitetet e projektit ishin zbatuar me mbështetjen e projektit për përfortim të kapaciteteve të RZR-së dhe anëtarëve, të financuar nga Organizata Suedeze Zhvillimore We Effect.



Panairi Ndërkombëtar për Bujqësi Bursa Agriculture 2019



Në organizim të shoqatës së prodhuesve të llojeve kopshtare dhe luleve "Horti Eko" nga Strumica, ishte realizuar një vizitë në Panairin Ndërkombëtar Bursa Agriculture 2019 dhe panairin e 12 për blegtori Bursa International Stock Breeding and Equipment Fair, që u zhvillua në periudhën 08.10-12.10.2019 në Bursa, R. e Turqisë.

Në panairin, anëtarët e SHPKL "Horti Eko" Strumicë kanë pasur mundësi të njoftohen me arritjet më të reja botërore në pjesën e mekanizimit bujqësor dhe teknologjisë, pajisjeve dhe materialeve prodhuese, gjitha nga sektori i blegtorisë, përfshirë edhe përpunime, prodhimtari organike, sisteme të ujitjes, mbrojtje, agro informatikë, farë dhe material mbjellës, etj.

Vizita në panair ka mundësuar shkëmbim të përvojave, qasje të reja në fushën e bujqësisë si dhe rrjetëzim dhe lidhje të veprimtarisë me kompani të njohura turke.



Shoqata e prodhuesve të ushqimit organik “Biovita” – Kavadar

Shoqata e prodhuesve të ushqimit organik “Biovita” – Kavadar në gusht, 2019, ka organizuar vizitë të Inkubatorit “Vitaç” me fëmijët e “Mal Grupen Dom” - Kavadar, me qëllim që të përhapin aktivitetet e tyre të përditshme. Banorët dhe kujdestaret janë njoftuar më hollësisht me prodhimtarinë organike në teren, për herë të parë kanë realizuar kontakt me bletët dhe kanë parë si duket një familje e bletëve. Aktivitetet tjera kanë të bëjnë me përfitimin e disa shkathtësive që do të jenë të dobishme gjatë viteve vijuese.

Në shtator të vitit 2019, SHPUO “Biovita” ka përfunduar me zbatimin e projektit “Inkubator për Bletari Organike – VITAÇ” që zbatohet në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), që është financuar nga Bashkimi Evropian (BE), ndërsa zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte ndalimi i shpërnguljes dhe gjallërimi i mjediseve rurale me anë të rritjes së numrit të grave dhe personave të rinj që themelojnë biznese me bletë sipas parimeve të bletarisë organike. Sipas parimeve të bletarisë organike ishin trajnuar 15 persona (bletar/bletare) prej të cilëve 11 kanë fituar Certifikatë për Bletari Organike. 13 persona të grupit synues janë bërë pronarë të dy familjeve të reja të bletëve si produkt i kultivimit të bletëve. Gjatë kohëzgjatjes së projektit më tepër se 200 persona janë informuar për rëndësinë e termit prodhimtari “organike”, si dhe normat dhe rregullat për zbatimin e bujqësisë.





Në shtator, ekipi i SHPUO "Biovita" ka marrë pjesë në ngjarjen "Dita e Organizatave Qytetare" të orgnaizuar nga Civica Mibil-itas, në të cilën kanë përdorur mundësinë për të zbatuar anketën në temën "Çfarë dini për prodhimtarinë organike?". Pas analizës së zbatuar të përgjigjeve të fituar nga anketa, ishte arritur konkluzioni që duhet të zbatohen fushata më të shpeshta të temës së prodhimtarisë organike, me çfarë do të ndikohet mbi vetëdijen e konsumatorit për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Në tetor, SHPUO "Biovita" nga Kavadari, në bashkëpunim me "Viki Klubin" nga Shkupi, në mënyrë vullnetare ka zhvilluar punëtori prej tre orëve në Porta Maqedonia. Para të pranishmëve, 8 nxënës të shkollës së mesme të gjimnazit Josip Broz Tito - Shkup, Goran Kolev, nga shoqata "Biovita" ka prezantuar dallimin mes mënyrës organike të prodhimit dhe mënyrës konvencionale. Personat entuziast kanë përkthyer tekste nga Wikipedia lidhur me prodhimtarinë organike, dhe për këtë, në gjuhën maqedonishte, mund të lexohen 7 artikuj të reja në temën e prodhimtarisë organike: peshq organik, veshmbathje organike, tokë e papërpunuar organike, fasule organike, ndryshime klimatike dhe bujqësi, hortikulturë organike dhe skema e shportës me perime organike.





Në tetor SHPUO "Biovita" ka organizuar vizitë të grupit për 15 gra fermerë nga Kosova, anëtare të Fondacionit "Gratë Fermere – Suharekë" në rajonin e Tikveshit, ku kanë vizituar katër gra rurale që merren me bujqësi dhe përpunim të produkteve bujqësore, një pjesë e tyre edhe prodhues organik. Ishin vizituar: Nada Marinkoviq, në f. Gradsko, me kapacitet përpunues të prodhimeve të bletëve, Vesna Janevska, nga f. Rosoman, që merret me kultivimin dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në mënyrën tradicionale, Lubica Mitrevska nga Kavadar që merret me prodhimtarinë e shurupit të rrushit, a.q. maxhun, si dhe kompaninë Eko-Grup me kapacitet përpunues për përpunim dhe prodhimtari të produkteve organike vegane. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave me gratë fermerë të rajonit të Tikveshit, gjatë të cilës gratë fermer anëtare aktive të Fondacionit Suva Reka kanë pasur mundësitë të dëgjojnë për sfidat, aktivitetet dhe vendimet e grave rurale në vendin tonë.



Në nëntor, SHPUO "Biovita" – Kavadar ka promovuar produktet e anëtarëve në ngjarjen "Degustimi i verërave cilësore të këtij viti të anëtarëve të shoqatës "Verërat Familjare të Tikveshit" dhe pjesëmarrësit e garës së "Mllado Vino 2019", që ishte zhvilluar në restorantin "Sino" - Kavadar.



SHPUO "Biovita" – Kavadar vazhdimisht ka përfshirë anëtarët në trajnime të ndryshme dhe punëtori, me qëllim të rritjes së kapaciteteve dhe njohurive, si dhe të sigurojë transparencë gjatë punës së dhe përhapjes së vizionit të shoqatës për mjedis jetësor të shëndoshë, cilësor dhe të mirë.

Rezidenca ndërkombëtare artistike “Art Point – Gumno 2019”



Rezidenca ndërkombëtare artistike, shoqata “Art Point – Gumno” organizon ngjarjen gjatë 17 viteve të fundit në mënyrë tradicionale. Qëllimi është që në vend të sillet botën dhe vlerat që promovon, dhe pastaj, qëndrimin në Slloeshticë, të ftuarit e tyre mbeten ambasadorë më të mirë kulturor për Maqedoninë.

Këtë vit, ata kanë mbështetur dy artiste të reja, jashtëzakonisht të talentuar: Xhesika Fleming, piktoe nga Gjermania dhe Ester Shabik, fotografe nga Sllovakia. Atyre, si mentorë, ju kanë bashkëngjitur artistët e mirënjohur Dik Roberts nga SHBA (piktor, poet dhe muzicient që vazhdimisht është vizitor i rregullt dhe rezident i fshatit), prof. Dr. Eros Ishtvan nga Hungaria (që, mes tjerash, është drejtor artistik i Bienales Koreane për Art nga/në Natyrë) dhe fotografi artistik maqedonas Sasho N. Alushevski.

Këtë vit, në gumnon artistike, ishte festuar natyra e temës që ata kanë përpunuar gjatë kohës: “Natyra paralajmëron: A jeni të zgjuar?!”. Të inspiruar nga pasuritë e jashtëzakonshme natyrore të maleve të Demir Hisarit të epërm, që për fat të keq, nuk janë të kursyer nga ndotja dhe ndryshimet globale klimatike, artistët, me anë të veprave të tyre, kanë protestuar dhe kanë pro-





vokuar në emër të natyrës dhe plantit Tokë. Përveç artit, ishin organizuar edhe aksione për pastrimin e fshatit dhe punëtori kreative me gjithë 30 nxënësit e SHMK "Vëllezërit Milladinovski" nga f. Zhvan.

Me këto aktivitete, "Art Point - Gumno" ishte bashkuar javës së "Aksionit Global për Ndryshime Klimatike: 20 – 27 shtator 2019".

Rezidenca artistike ishte mbështetur në mënyrë simbolike nga Ministria e Kulturës në kuadër të thirrjes për financim të projekteve me interes kombëtar për kulturë në vitin 2019.

Fillon realizimi i IPA projektit "Zbulimi i atraksioneve të fshehura"

Më 5 dhjetor të këtij vitit, ishte nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim për projekt 20 mujor ndërkufitar me Shqipërinë. Qëllimi i projektit është promovimi i rajonit ndërkufitar si atraksion turistik me anë të promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Bartës i projektit është Komuna e Demir Hisarit në krye me kryetarin e komunës Marjançe Stojanovski, ndërsa partner lokal nga ana maqedonase është "Art Point – Gumno". Nga ana shqiptare, partnerë janë komuna Killoso, në krye me kryetarin Ilmi Hoxha dhe Fondacionin për Autonomi dhe Drejtim Lokal "Flag".

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit për bashkëpunim ndërkufitar 2014-2020 dhe me buxhet të plotë prej 455.663,00 euro.




Sherbele – medikamenti i shekullit

Më 16.11.2019 në Pehçevë ishte zhvilluar takim informativ për promovimin e rezultateve të aktiviteteve që ishin realizuar në kuadër të projektit "SHERBELE – MEDIKAMENTI I SHEKULLIT". Organizator i takimit ishte organizata ekologjike qytetare Lëvizja për Rrethinën MOLIKA –DOM, Manastir në partneritet me shoqatën ekologjike "Kladenec" – Pehçevë.

Ky aktivitet ishte mbështetur financiarisht nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë së Veriut në kuadër të projektit "Ngritja e kapaciteteve të RZR dhe anëtarëve të saj" financuar nga Organizata Suedeze Zhvillimore We Effect.

Me anë të seancave informative, 6 ekonomi bujqësore të rajonit të Pellagonisë dhe Maleshevisë, kanë përfituar njohuri për operacionet e zakonshme të punës – masat agroteknike (përgatitje e tokës, pleh, prodhimi i fidanëve, rregullimi i fidanishtes, kontrolli i barit të keq, mbrojtja nga dëmtuesit dhe sëmundjet, ujitja, vjelja dhe magazinimi). Gjithashtu, kanë pasur mundësi të fitojnë më tepër të dhëna për përmbajtjen e dheut dhe pjellshmërinë e tokës, si dhe zgjedhjes së llojit ose species së sherbelës që është e përshtatshme për kultivim.



Në këtë mënyrë, me anë të organizimit të takimeve informative në të cilat janë ndarë përfitimet nga kultivimi i kësaj bime shëruese dhe aromatike, me theksim të përfitimit ekonomik me anë të shitjes dhe vendosjes tek prodhuesit e fundit (farmaci, industri ushqimore, etj.), ishte arritur qëllimi i fundit për projektin që të nxiten ekonomi bujqësore të rajonit të Pellagonisë dhe Maleshevisë, për kultivim të sherbelës.

Zhvillohet kuvendi vjetor i Rrjetit për Zhvillim Rural



Kuvendi vjetor i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë së Veriut u zhvillua në Dojran më 3 shtator. Disa prej anëtarëve më aktiv të RZR që kanë marrë pjesë në Kuvendin, ishin informuar për aktivitetet aktuale dhe të planifikuara dhe iniciativa të Rrjetit të drejtuar për përf forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e ndikimit në proceset e zhvillimit rural në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Ishin prezantuar aktivitetet për zhvillim institucional të RZR dhe aktivitetet e zbatuar për zhvillim të kapaciteteve të Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural të mbështetur nga Agjencia Suedeze Zhvillimore We Effect, si dhe aktivitetet e projektit për rrjetëzim dhe përfaqësim për ekonomi të gjelbër të financuar nga Komisioni Evropian.

Si një prej ngjarjeve më të rëndësishme të këtij viti, ishte prezantuar parlamenti rural kombëtar i parë në vend, që ishte zhvilluar nga 12 deri më 14 qershor 2019, si ngjarje e fundit e projektit "Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale" të mbështetur nga BE-ja.



Nga ana e koordinatorit të grupit tematik për LEADER të Rrjetit për Zhvillim Rural, ishte nxitur një diskutim mbi LEADER si vegël efikase për zhvillimin e mjediseve rurale dhe një temë që është me interes të veçantë për anëtarët e RZR-së.

Rrethi studimor si metodë e mësimi që ekziston më tepër se 100 vite dhe është i zhvilluar posaçërisht në vendet Skandinave, ishte prezantuar në kuvendin vjetor për të nxitur shoqatat që mendojnë për mundësitë dhe përfitimet nga zbatimi në mjediset rurale.

Anëtarët e pranishëm ishin aktiv në diskutimet dhe kanë shprehur interes të lartë që të përfshihen në aktivitetet vijuese të Rrjetit dhe të kontribuojnë për arritjen e qëllimeve të Rrjetit.



Rrjetëzim i anëtarëve të RZR-së

Për të rritur rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes organizatave-anëtare të Rrjetit për Zhvillim Rural, ishte organizuar një ngjarje dy-ditore në Strugë, më 28 dhe 29 nëntor. Gjatë ngjarjes, përfaqësuesit e organizatave kanë pasur mundësinë të promovojnë aktivitetet e tyre dhe rezultatet në kuadër të aktivitetit të quajtur mini-panair, si dhe të shkëmbejnë përvoja, informacione dhe ide për bashkëpunim të përbashkët dhe zbatim të aktiviteteve për zhvillim të mjediseve rurale.

Ky aktivitet ishte zbatuar si pjesë e projektit për mbështetje institucionale të RZR-së dhe anëtarëve, të mbështetur financiarisht nga Organizata Suedeze Zhvillimore We Effect.



Në kuadër të projektit për Mbështetje Institucionale të RZR-së dhe anëtarëve, mbështetur nga Organizata Suedeze Zhvillimore We Effect, më 3 maj të këtij viti, ishte publikuar thirrje për mbështetje të iniciativave për projekte nga anëtarët e RZR-së. Gjithsej 20 organizata ishin mbështetur financiarisht të zbatojnë 10 iniciativa projekti për periudhë maksimale prej 6 muajve.

Projektet vijuese ishin zbatuar gjatë periudhës vijuese:

1. Titulli i projektit: Të rinjtë dhe natyrë – partnerë për ardhmërinë

Bartës i aplikimit:

Shoqata Qendra për Bimë Shëruese dhe Fruta Mali “Ambrozija” – Pehçevë

Partner:

Shoqata Ekologjike Solza – Pehçevë

Qëllime të projektit: Sigurimi i parakushteve për përdorim të qëndrueshëm të resurseve natyrore, ulja e ndotjes me anë të edukimit dhe ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e mjedisit jetësor dhe llojllojshmërinë biologjike.





2. Titulli i projektit: Nga mbeturina organike deri tek ushqimi i shëndetshëm

Bartës i aplikimit:

Shoqata e qytetarëve EKOVIDA

Partner:

Shoqata për Mbrojtjen e Natyrës nga Ndotja Çista Voda – Zdrava Hrana, Dibër

Qëllimi i projektit: Nxitja e të rinjve, nga fshatrat rurale për fillimin e aktiviteteve ekonomike, dhe me anë të përdorimit të natyrës për fitimin e produktit cilësor bujqësor.

3. Titulli i projektit: Nxitja e iniciativave rinore në mjediset rurale

Bartës i aplikimit:

Fondacioni për zhvillim lokal dhe zhvillim të teknologjive informatike (FLORIT),

Partner:

Shoqata KRUNA PLUS

Qëllimi i projektit:

Nxitja e aktivizmit rinor në mjediset rurale si masë për llojllojshmërinë ekonomike

4. Titulli i projektit: Fushatë për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe të punës në bujqësi

Bartës i aplikimit:

Shoqata e prodhuesve të produkteve kopshitare dhe luleve Horti Eko

Partner:

Shoqata Grupi Lokal i Aksionit Bellasica Ograzhden

Qëllimi i projektit: Ulja e ndikimit të dëmtueshëm të bujqësisë mbi mjedisin jetësor dhe parandalimi i përdorimit të padrejtë të resurseve kryesore natyrore.





5. Titulli i projektit: Promovimi i konceptit LEADER

Bartës i aplikimit:

Shoqata për zhvillim rural Grupi Lokal i Aksionit Pijanec-Malesh

Partner:

Qendra për zhvillim lokal CELOR

Qëllimi i projektit: Promovimi i masës LEADER dhe afirmimi i GLA-ve në rajonin me anë të aktiviteteve dhe masave që janë pjesë e GLA dhe LEADER në Bashkimin Evropian, promovimi i bashkëpunimit të përbashkët, përf forcimi i vetëdijes për rëndësinë e rajoneve për zhvillimin dhe promovimin e potencialeve të fushave rurale, si pjesë e parimit LEADER dhe afrim të rëndësishëm të Grupeve Lokale të Aksionit për përmirësim të cilësisë së jetës.



6. Titulli i projektit: Promovimi i vlerave kulturore dhe natyrore të mjediseve rurale.

Bartës i aplikimit:

Shoqata për zhvillim rural Grupi Lokal i Aksionit Pllaçkovica

Partner:

Shoqata për zhvillim rural Grupi Lokal i Aksionit Bojmija

Qëllimi i projektit:

Promovimi dhe përfaqësimi i qasjes LEADER në Republikën e Maqedonisë së Veriut



7. Titulli i projektit: SHERBELE – MEDIKAMENTI I SHEKULLIT

Bartës i aplikimit:

Lëvizja për rrethinën MOLIKA – DOM Ma-nastir

Partner:

Shoqata ekologjike Kladenec

Qëllimi i projektit: Të nxiten ekonomi bujqësore të rajonit të Pellagonisë dhe Maleshevisë për kultivim të sherbelës, me anë të organizimit të takimeve informative në të cilat janë ndarë përfitimet nga kultivimi i kësaj bime shëruese dhe aromatike, me theksim të përfitimit ekonomik me anë të shitjes dhe vendosjes tek prodhuesit e fundit.

8. Titulli i projektit: Gratë rurale për zhvillim rural

Bartës i aplikimit:

Fondacioni për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik PREDA plus

Partner:

Organizimi i grave VIZION

Qëllimi i projektit: Ngritja e vetëdijes së komunitetit lokal për rëndësinë e barazisë gjinore, si dhe të sigurojë mbështetje të grave rurale në pjesën e prodhimtarisë dhe përfshirjes së tregut të punës, Preda Plus dhe vizioni do të realizojnë aktivitete për promovim të barazisë gjinore, përmirësimin të statusit të grave dhe kapaciteti i tyre për miratimin e vendimeve në gjitha nivelet dhe në gjitha sferat e jetës si faktor për ngritjen e zhvillimit të qëndrueshëm rural.



9. Titulli i projektit: Gra aktive në mjediset rurale – në mënyrë kontribuojnë për zhvillimin e komunitetit lokal

Bartës i aplikimit:

Koalicioni Rural

Partner:

Shoqata e grave fermerë Moja Farma

Qëllimi i projektit: Gratë e mjedisve rurale bëhet aktorë të barabartë aktiv në avancimin e ekonomisë familjare bujqësore dhe zhvillimin ekonomik të komunitetit lokal.

10. Titulli i projektit: Krijimi i strategjisë lokale për promovim dhe mbrojtje të resurseve natyre të Sarajit-Matkës

Bartës i aplikimit:

ZIP Instituti

Partner:

Qendra për bujqësi të qëndrueshëm dhe zhvillim rural

Qëllimi i projektit:

Identifikimi i gjitha potencialeve të njohura turistike të Sarajit, ndikimi i vetëdijes për rëndësinë e lokaliteteve turistike, oferta turistike ndaj qytetarëve dhe popullatës lokale nga njëra anë, dhe autoritetet lokale dhe roli i tyre në këto procese nga ana tjetër.

Shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas nga Mjedisit Rural - 15 tetor



Dita Ndërkombëtare e Mjedisit Rural - 15 tetori, këtë vit ishte shënuar me një ngjarje në Demir Kapi, që ka organizuar Rrjeti për Zhvillim Rural (RZR) dhe Federata Kombëtare e Fermerëve (FKF) me mbështetjen e organizatës suedeze për zhvillim We Effect.

Më tepër se 200 përfaqësues të institucioneve qeveritare, organizatat qytetare të vendit dhe nga Ballkanit, si dhe banorë të mjediseve rurale, kanë marrë pjesë në këtë ngjarje me qëllim të shqyrtojnë rezultatet e Deklaratës së vitit të kaluar të nënshkruar dhe bashkëpunimin mes institucioneve dhe organizatave joqeveritare.

Si rezultate pozitive ishin theksuar ndryshimet të arritura gjatë programit katërvjetor për zhvillim rural 2018-2021, në kërkesë të Federatës Kombëtare të Fermerëve, me të

cilat ishin larguar masat diskriminuese. Kjo kërkesë ishin mbështetur nga Rrjeti për Zhvillim Rural, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Organizata Suedeze për Zhvillim We Effect, Fakulteti për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim, UN Women dhe organizata tjera ndërkombëtare dhe kombëtare.



Në drejtim të përmirësimit të mëtutjeshëm të gjendjes së grave rurale në vend, Vaska Mojsovska, kryetare e Federatës Kombëtare të Fermerëve, ka theksuar që: "Federata Kombëtare e Fermerëve kërkon themelimin e një pako të masave për rritje të mundësive për punësim të grave nga mjediset rurale; krijimi i masave për njohjen punës së papaguar të grave, gjetja e zgjidhjeve për gratë nga mjediset rurale që nuk kanë realizuar të drejtën e pensionit me anë të ndryshimit të Ligjit për Pension Social, si dhe me ndryshime të Ligjit për Sigurim Shëndetësor për të realizuar të drejtën e mungesës së prindërve dhe pushim për sëmundje të fermerëve të regjistruar, gjegjësisht fermerë."

Aneli Leina, drejtoresha rajonale e Organizatës Suedeze Zhvillimore We Effect, në drejtimin e saj theksoi që "përforsimi i të drejtave të grave rurale është me rëndësi themelore për zhvillim dhe prosperitet të komunitetit rural. Kur gratë rurale mbështeten dhe të drejtat e tyre janë të garantuar, efektet pozitive janë të dukshme jo vetëm në familjet e tyre, por edhe në komunitetin dhe gjithë shoqërinë. Ato janë ardhmëria e ekonomisë rurale dhe prandaj duhet të kenë më tepër mundësi, zë dhe fuqi vendimi në komunitetin e tyre, ndërsa të drejtat e tyre duhet të mbrohen."

Kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural, Petar Gjorgievski, ka theksuar: "E dimë që në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka lehtësime për gratë nga mjediset rurale që aplikojnë për masat aktuale të mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural me anë të Programit Kombëtar për Zhvillim Rural dhe IPARD, por mendoj që duhet të rritet edhe stimulimi i grave sipërmarrëse dhe të jepet mbështetje për gratë që do të jenë bartës të ardhshëm të projekteve, me anë të sigurimit të më tepër informacioneve, nxitjes, dhënies së ideve afariste dhe sigurimit të lidhjeve afariste me anë të mënyrave të ndryshme të rrjetëzimit."



Në drejtimin e tij, Nikollçe Babosvski, drejtori i Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural, ka theksuar që "në IPARD 1 pothuaj se 3% të aplikacioneve ishin të dorëzuar nga gratë. Me IPARD 2, 23% të kërkesave ishin dorëzuar nga gratë. Prej 73 aplikacione për prokurimin e kafshëve race 33 janë të aprovuar për gratë. Për prokurim të traktorëve prej 1347 – 343 janë për gra."

Në ngjarjen ishte drejtuar Nefrus Çeliku, sekretari shtetëror në Ministrinë e Arsimit, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit që ka theksuar që në kuadër të këtij institucioni funksionon grupi koordinues për barazi gjinore që përcakton masën 115 të Programit për Mbështetje Financiare për Zhvillim Rural që së shpejti do të publikohet dhe synohet për gratë e mjediseve rurale. Në ngjarjen ishin drejtuar edhe Elena Grozdanovska, këshilltar shtetëror për mundësi të barabarta në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ermira Lubani, këshilltar teknik rajonal i zyrës



së UN Women në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që theksoi që me anë të përdorimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si vegël dhe nyja mes formulimit të politikave dhe zbatimit të tyre mund të mbyllet. Kjo do të kontribuojë për përdorimin më të mirë të resurseve, drejtimin më të mirë dhe demokraci të përforcuar që kanë theksuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor si vegël për krijimin e politikave.

Pas fjalimeve hyrëse ishte zhvilluar edhe diskutim publik në temën "Pronësia e tokës bujqësore dhe prona – sfida për gruan rurale". Në diskutimin publik ishin përfshirë edhe fermerët Juliana Velkovska dhe Stevançe Jordanovski, përfaqësuesja e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural, Andrijana Velevska, këshilltare shtetërore për zhvillim rural në MBPEU, dhe koordinatore e grupit për barazi

gjinore në MBPEU dhe Neda Çallakovska, zyrtare programore për barazi gjinore dhe minoritet në We Effect. Ata kanë diskutuar edhe kanë ndarë të dhëna relevante lidhur me pronësinë e tokë bujqësore dhe pronës, si një prej sfidave më të mëdha për gratë në mjediset rurale.



Rrjeti për Zhvillim Rural Ballkanik ishte themeluar zyrtarisht!



Që prej themelimit joformal në mars të vitit 2011, Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural – RBZR, me përpjekje të përbashkëta të anëtarëve, ka filluar të bëhet e njohur në mesin e organizatave relevante ndërkombëtare dhe institucionet publike, në atë rajonal por edhe në nivelin e BE-së, si aktor potencial kryesor në zhvillimin rural të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Anëtarët e RBZR-së kanë punuar shumë gjatë 8 viteve të fundit dhe kanë dedikuar një pjesë të madhe të kohës dhe energjisë për vendosjen e shtyllave të qëndrueshme, që mund të ndërtojnë një figurë eminente mes aktorëve rural në rajon dhe më gjerë. Me formalizimin e RBZR ata janë duke lëvizur një hap drejt formimit të një aktori të fuqishëm social në komunitet rurale të Ballkanit që do të kontribuojnë në mënyrë të dukshme zhvillimin e rajoneve të qëndrueshme rurale të rajonit. Asambleja themeluese e RBZR ishte zhvilluar në Shkup, më 6 dhjetor, kur rrjetet e zhvillimit rural të Maqedonisë së veriut, Malit të Zi, Kosovës,





Kroacisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës kanë nënshkruar dokumentet e regjistrimit si themelues të Rrjetit. Dy anëtarët tjerë të RBZR, rrjetet e zhvillimit rural të Serbisë dhe Shqipërisë do të bashkohen më vonë si anëtarë të plotë. Në këtë mënyrë RBZR do të vazhdojë të përfaqësojë më tepër se 200 shoqata të zhvillimit rural nga rajoni dhe do të përfaqësojë interesat e më tepër se 9 milion popullatë rurale të vendeve të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbisë.

“Unë pres që RBZR do të dëshmojë të jetë një aktor social për komunitetet rurale ballkanike, që do të mundësojë të përdor mundësitë dhe fuqitë e sotme, për të anuluar sfidat e të nesërme dhe kontribuojë për zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme për çështjet aktuale dhe të ardhshme sociale dhe rurale”, tha Petar Gjorgievski, presidenti i ri i zgjedhur i Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural – RBZR.

Duke falënderuar mbështetjen nga Organizata Suedeze Zhvillimore We Effect gjatë 2 viteve të fundit, RBZR ka arritur të vendos një bazë të fuqishme për organizatën dhe të përgatit dokumentet themelore që japin drejtime dhe qëllime për punën në të ardhmen.

Parlamenti Evropian Rural i 4-të dhe Parlamenti Rural Rinor i 2-të (ERYP) i zhvilluar në Spanjë



Gjatë periudhës prej 6 deri 9 nëntor 2019, gjithsej 335 delegatë që kanë përfaqësuar 38 vende evropiane, përfshirë edhe popullatën rurale, përfaqësues të organizatave të shoqërisë qytetare, kërkues, qeveri kombëtare dhe institucioneve të Bashkimit Evropian, janë mbledhur në fshatin Candás, rajoni i Asturias, në Spanjë, për Parlamentin Rural Evropian të 4-të. Kjo ngjarje ka **thirrur për një "një agjendë të vërtetë të fiksuar"** mes shoqërisë qytetare dhe organizatave politike që dizajnojnë politikat, ku



“bashkëpunimi dhe partneriteti i përfshirë i gjitha niveleve janë të kombinuar për të siguruar që Evropa rurale të përparojë”. 5 përfaqësues të RZR të MV kanë marrë në ngjarjen dhe kanë diskutuar me aktorët tjerë rural në lidhje me tema të ndryshme të zhvillimit rural në vendet Evropiane, duke kontribuar me sugjerime dhe propozime në lidhje me politikat rurale që të trajtohen me anë të Deklaratës së Candas. Deklarata ka mbledhur bashkë kërkesat e popullatës rurale evropiane dhe që do të dërgohen në Bruksel në janar 2020 që të prezantohen para institucionet e BE-së bashkë me Candas Manifesto.



Kjo Deklaratë përfshin dhjetë thirrje për veprim të identifikuar nga 66 pjesëmarrës të rinj nga 15 vende gjatë **Parlamentit Evropian Rinor Evropian të 2-të (ERYP)** që ishte paraprakisht i zhvilluar në Candas, mes 4 dhe 6 nëntor.

Kjo Deklaratë, mbështetur dhe nënshkruar gjatë të mbledhjes së tretë plenare të ERP të zhvilluar më 9 nëntor, mbledh bashkë debatet mbi të cilat puna ishte zhvilluar gjatë javës, si në Parlamentin Rinor ashtu edhe në atë vijues, për trendët aktuale të parashtruar nga sfidat me të cilat përballohet popullata rurale Evropiane. Pyetjet si çmimi politik dhe ekonomik që paguhet për ikjet, debimi dhe rritja e popullizmit, a janë qeveritë kombëtare dhe BE-ja tepër e lidhur me mendimin për rritjen të kombinuar me agjendën dominuese urbane, a është të menduarit sektorial, programimi, drejtimi dhe financimi zgjidhja më e mirë për komunitetet rurale dhe ekonominë, janë këto kërkesa të bazuara.

Gjatë ekspozitës së organizuar brenda ERP, Rrjeti për Zhvillim Rural i Ballkanit ka pasur standin e tyre në të cilën aktivitetet e RZRB dhe përpjekjet drejt përmirësimit të rajoneve rurale të Ballkanit ishin prezantuar, si dhe mbështetje organizative e RZRB që ishte dhënë nga Organizata Suedeze për Zhvillim We Effect.



Menaxhimi financiar dhe diversifikimi i financave



Trajnimi i tretë kombëtar për zhvillimin e shkathtësive gjenerike të menaxhimit të organizuar në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe përfaqësimi i ekonomisë së gjelbër”, ishte zhvilluar në Demir Kapi, nga 2 deri më 4 qershor 2019. Më tepër se 30 përfaqësues të organizatave qytetare nga Maqedonia e Veriut kanë marrë në këtë trajnim të dedikuar “Menaxhimit financiar dhe diversifikimit të financave”. Fokusi kryesor i këtij trajnimi ishte transferimi i njohurive për prokurime dhe menaxhim financiar të projekteve të BE-së si mundësi për diversifikimin e financimit të organizatave qytetare. Pjesëmarrësit e trajnimit kanë marrë sqarim për procedurat e prokurimit, PRAG procedurat, përgatitjen e buxhetit, kontrolli i brendshëm financiar, njoftimi financiar për projekte të BE-së dhe tjera.

Ky trajnim ka ndihmuar për të përforcuar potencialet dhe kapacitetet e organizatave më të vogla qytetare rurale që veprojnë në fushën e zhvillimit rural të mjediseve rurale.



Zbatohet trajnim rajonal i trajnuesve për qasjen LEADER



Rreth 30 përfaqësues të GLA-ve dhe iniciativat për GLA, prej 6 vendeve të Evropës Juglindore (Maqedonia e Veriut, Serbisë, Shqipërisë, Kosovë, Malit të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë) janë mbledhur në Shkup për trajnim 4 ditor të trajnerëve për qasjen LEADER dhe CLLD – zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti. Ky trajnim është aksion vijues i bazuar në temat prioritare për trajnim dhe rekomandimet që dalin nga vlerësimi i nevojave për trajnime të zbatuar në këto 6 vende.

Këto aktivitete i zbaton Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë së Veriut në kuadër të programit rajonal "Mbështetje të diversifikimit të rajoneve rurale në Evropën Juglindore (SEDRA)" zbatuar nga GIZ dhe SWG.

